



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.11.2023
REFERENC-Ë:	21/201/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K. Hydrocentrali "SHARRI" në Shtërpçë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar / a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., me Nr. Prot. 21/201/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për Refuzimin e Lejes Mjedisore për operatorin "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., për hidrocentralin "SHARRI" në Shtërpçë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 21/201/MMPHI

Datë: 17.11.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 12 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Pëlqimit Mjedisor me Nr. 14/3721/1-ZSP/182/14, të lëshuar me dt. 09.09.2014, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të datës 16.11.2023 dhe vazhdimi i takimit të datës 17.11.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., i refuzohet kërkesa për pajisje me Leje Mjedisore, për hidrocentralin "SHARRI" në ngastrën kadastrale nr. 2374-0, zona kadastrale Shtërpçë.


A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "MATKOS GROUP HC SHARRI" SH.P.K., për hidrocentralin "SHARRI" ngastrën kadastrale nr. 2374-0, zona kadastrale Shtërpçë, është konstatuar se Operatori nuk i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, pasi që mungojnë plotësimi i kushteve si në vijim:

Faqe 2 nga 4



- Ndërrimi (devijimi) i trasesë nga koordinatat e shënuara ne raportin e VNM- së;
- Nuk ka Pëlqim Mjedisore për ndërrim apo devijim te trasesë;
- Traseja kalon neper Zonën e II te Mbrojtur te Parkut Kombëtar "Sharr" me gjatësi 1056 metra, shih hartën me poshtë.



Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, merr Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore ne përputhje me paragrafin 3 te nenit 12, te Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Shtërpçë-së;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Komisionit te Leje mjedisore;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.